

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	635-26-957-1-1-1
Nr i brendshëm	635/26/008/111

Sa i përket tenderit për: **“Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore te QKMF-se”.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“MEDPLUS SH.P.K.”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lebanë, Rr. Pranvera e Lirisë,p.n

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344640420

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


medplusks@gmail.com

(Adresa elektronike)

30.04.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 03.03.2026

Kërkesa për rishqyrtim dt.18.03.2026

Vendimi për Refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt19.03.2026

Ankesa në OSHP dt.26.03.2026

Ekspertiza e eksperteve të OSHP-së dt.10.04.2026 Nr.**2026/0186**

Vendimi i panelit Shqyrtues dt.21.04.2026 **OSHP: 2026/0186**

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 24.04.2026

Kërkesa për rishqyrtim dt:27.04.2026

Vendimi për aprovim të pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim: 28.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur gjeni vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim!

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 19 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 37 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Ekspertiza e eksperteve të OSHP-së dt.10.04.2026 Nr.2026/0186

Vendimi i panelit Shqyrtues dt.21.04.2026 OSHP 2026/0186.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqjen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftim Kronologjik

Ky aktivitet i prokurimit ishte ritenderuar, pasi që ishte anuluar në vlerësimin e kaluar pas tendencave diskriminuese ndaj kompanisë tonë dhe tendencave favorizuese për OE të cilin e kishte rekomanduar për kontratë autoriteti kontraktues.

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt.03.03.2026, ndërsa hapja e ofertave fillimisht ishte planifikuar të bëhet me dt. 24.03.2026.

Kundër njoftimit për kontratë, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.18.03.2026 për shkak të specifikave diskriminuese, përmendjes së emrave tregtar dhe disa pretendime tjera për përbërje diskriminuese/favorizuese të produkteve. Kërkesa jonë për rishqyrtim ishte refuzuar me Vendimin e dt19.03.2026.

Pas kësaj ne kemi parashtruar Ankesë në OSHP me dt.26.03.2026. Në lidhje me ankesën tonë ishte lëshuar Ekspertiza e eksperteve të OSHP-së me dt.10.04.2026 Nr.2026/0186, ku ishte aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa dhe ishte rekomanduar që të bëhen përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjatet afati për ofertim.

Vendimi i panelit Shqyrtues ishte lëshuar me dt.21.04.2026 me Nr. 2026/0186, ku ishin mbështetur konstatimet e eksperteve të OSHP-së.

Autoriteti kontraktues ka publikuar formularin standard për korrigjim e gabimeve ne njoftimet e publikuara dhe si datë të fundit për ofertim e ka lënë datën 04.05.2026, ndërsa ka bërë korrigjimin e dosjes por që të disa produkte nuk i ka respektuar mendimet e eksperteve të OSHP-së dhe të panelit shqyrtues.

Në vijim po i paraqesim pretendimet tona ankimore ndaj formularit standard për korrigjim e gabimeve ne njoftimet e publikuara:

I. Në lidhje me pozicionet 68 dhe 69 tani janë ndryshuar specifikimet teknike dhe formulimet nga dosja e kaluar por tani kemi favorizim edhe më të madh dhe më të hapur, sepse nuk është lejuar ekuivalenca por është shënuar se “Specifikat janë minimale munde të ofertoni me specifikacion me të mire”

Specifikimet teknike për këto dy produkte, tani pas korrigjimit janë shënuar si më poshtë:

68	Dezinfektues per duar 100g tretesire permban perberesit aktiv te meposhtem/ 89.1 g Etanol 96% (Specifikat jane minimale munde te ofertoni me specifikacion me te mire) te prezantohet mostra para hapjes	liter	
69	Dezinfektues per dysHEME 100g permbajne / 12g etandial 0.5g pentanediale, 7.5g klorur didecildimetilamoniumi (specifikat jane minimale munde te ofertoni me specifikacion me te mire) te prezantohet mostra para hapjes	liter	

Për produktin **68** tani kemi specifikim **shumë të hollësishëm** dhe drejtpërdrejtë favorizues sepse është cekur **89.1 g Etanol 96%**. Përcaktimi i specifikuar 89.1 përbën favorizim të drejtpërdrejtë të një prodhuesi të caktuar pa pasur asnjë arsye profesionale, prandaj ky specifikim bie në kundërshtim të plotë me neni 28 paragrafi 7 të LPP-së, ku shkruan “7.” *Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi*”.

Përcaktimi i saktë i një vlere apo përqindje shpjen drejtpërdrejtë tek një prodhues i caktuar, prandaj duhet ndryshuar këto specifika dhe duhet hapur konkurrencën.

Po ashtu edhe për produktin në pozicionin **Nr.69** kemi përshkrim të hollësishëm të dezinfektuesit, prandaj edhe për këtë produkt kërkojmë që të lejohet **EKUIVALENCA**.

Përshkrimi 100 g përmbajnë/12g etendial 0.5g pentendial, 7.5g klorur didecildimetilamoniumi, është përshkrim i hollësishëm i cili shpie në favorizim të prodhuesve të caktuar dhe njëkohësisht është diskriminues për kompani të tjera, prandaj duhet të ndryshohet ky specifikim, duke lejuar dhe përcaktuar EKUIVALENCËN e përbërjes së produkteve, sepse me rëndësi është të arrihet qëllimi i përdorimit të këtyre dezinfektuesve.

Tani është cekur, specifikat janë minimale dhe mund të ofertoni me specifikacion më të mirë por nuk është përcaktuar dhe lejuar EKUIVALENCA, prandaj është kufizuar konkurrenca.

Përcaktimi kinse minimal i specifikave për dy produktet e lartcekura nuk ka asnjë arsyetim profesional, prandaj nëse duhet të përcaktohet minimumi i këtyre specifikave atëherë duhet të lejohet një **minimum i caktuar profesional** dhe që e përmbajnë dezinfektuesit e shumë prodhuesve dhe me të cilat specifika arrihet qëllimi dhe efekti i njëjtë i përdorimit të tyre, e jo të vendoset një minimum shumë i lartë, e që mund të favorizohet një prodhues. Pra duhet të përcaktohet një minimum profesional ose të lejohet EKUIVALENCA me qëllim të hapjes së konkurrencës.

Nuk mund të quhet ekuivalencë nëse thuhet se lejohen edhe më të mira por përbërja ekuivalente domethënë kur me përbërje tjetër të përafërt arrihet efekti dhe qëllimi i njëjtë. Pra duhet të lejohet ekuivalenca me qëllim që të arrihet efekti i njëjtë i dezinfektimit.

Prandaj duke u bazuar në këtë fakt, në lidhje me këto dy produkte/pozicione, paneli shqyrtues ka konstatuar veçantë se duhet të lejohet ekuivalenca, shih më poshtë konstatimet e panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues lidhur me pozicioni 68, konstaton se Autoriteti kontraktues duhet te lejoj ekuivalencen per produktin në ket pozicion dhe të permisohet kjo pike ne DT, sipas arsytimit te ekspertit teknik “sa i përket kërkesës për produktin dezinfektues për duar, bazuar në përshkrimin e specifikimeve teknike në DT, rezulton se produkti i kërkuar nuk përmban një dezinfektues klasik. Por, përbërësit e përfshirë, gjithashtu konzervuesi dhe lëndë ndihmëse posedojne kryesisht veti antifungale dhe japin një efekt të lehtë antibakterial që kontribuojnë në largimin mekanik të papastërtive dhe mikroorganizmave nga lëkura gjatë procesit të larjes duke rezultuar në një efekt indirekt higjienizues. Në këtë kontekst, bazuar në përshkrimin teknik dhe karakteristikat funksionale e mikrobiologjike, produkti i kërkuar i përgjigjet më tepër një shamponi/larësi për duar. Duke marrë parasysh se AK përmes vendimit për rishqyrtim, nuk ka lejuar aplikimin e parimit të ekuivalencës për funksion të njëjtë klinik parim ky që do të mundësonte ofertimin e produkteve teknikisht të përafërta për aq kohë sa përmbushin të njëjtin funksion. Për rrjedhojë, pretendimi ankimor lidhur me këtë pozicion vlerësohet si i bazuar.”

Paneli shqyrtues lidhur me pozicioni 69, konstaton se Autoriteti kontraktues duhet te lejoj ekuivalencen per produktin në ket pozicion dhe të permisohet kjo pike ne DT, sipas arsytimit te

ekspertit teknik”sa i përket përshkrimit të produktit në DT si dezinfektues për dysheme, nga analiza e specifikimeve teknike rezulton një mospërputhje ndërmjet emërimit dhe karakteristikave të kërkuara. Përshkrimi teknik i produktit primarisht është dezinfektues higjienik dhe kirurgjik i duarve, ndërsa përdorimi i tij për sipërfaqe apo dysheme është vetëm sekondar. Megjithëse produkte të tilla mund të përdoren edhe për dezinfektimin e sipërfaqeve, përfshirë dyshemetë, por një përdorim i tillë konsiderohet jo optimal nga aspekti teknik dhe ekonomik, për shkak të konsumit të lartë dhe kostos më të madhe krahasuar me dezinfektuesit e dedikuar për sipërfaqe, meqenëse AK nuk ka lejuar parimin e ekuivalencës gjatë kërkesës për rishqyrtim, pretendimi ankimor lidhur me këtë pozicion vlerësohet si pjesërisht i bazuar”.

Pra, paneli shqyrtues ka detyruar autoritetin kontraktues që të lejojë **EKUIVALENCËN** për përbërjen e këtyre produkteve, ndërsa autoriteti kontraktues me korrigjimin e dosjes së tenderit nuk ka lejuar ekuivalencën, duke mos respektuar vendimin e panelit shqyrtues por përkundrazi ka kufizuar edhe më shumë konkurrencën duke specifikuar edhe më detajisht dhe në mënyrë edhe më të hollësishme specifikimet dhe formulimet e produkteve dhe në këtë mënyrë ka kufizuar konkurrencën.

Kërkojmë që detyrimisht për produktet në pozicionet nr. 68 dhe 69 të lejohet **ekuivalenca**, ose eventualisht që këto dy produkte të ndahen në një lot të veçantë sepse janë dezinfektues dhe nuk e kanë vendin së bashku me produktet e tjera. Ky pretendim i yni bëhet për faktin se siç edhe e kemi theksuar më lartë, specifikimet teknike janë formuluar në mënyrë shumë të detajuar, duke u specifikuar saktë përbërja e produkteve në mënyrë të hollësishme, veprim ky që e bën praktikisht të pamundur ofertimin për operatorët ekonomik me përvojë të madhe në fushën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për prodhues të tjerë, por që nuk i posedojnë këto produkte në përbërje kaq strikte dhe të detajuar. Në rast se nuk lejohet ekuivalenca për këto produkte, atëherë mbajtja e këtyre dy produkteve brenda të njëjtit lot me produktet e tjera ndikon drejtpërdrejt në pa mundësinë e ofertimit për të gjithë aktivitetin e prokurimit, pasi që mjafton që OE të mos plotësojnë strikt përbërjen e këtyre dy produkteve dhe të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit.

Thjesht autoriteti kontraktues e ka kurdis këtë tender, fillimisht duke përfshi dezinfektues në këtë aktivitet të prokurimit dhe më pastaj duke specifikuar strikt dhe në mënyrë shumë të hollësishme specifikimin teknik.

Pra përmes këtyre dy dezinfektuesve, autoriteti kontraktues tenton ta favorizojë një OE dhe ta diktojë tërë procesin e prokurimit në mënyrë të kundërligjshme, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që ta kuptojë drejtë këtë pretendim ankimor dhe ta parandalojë diktimin e këtij procesi të kundërligjshëm dhe të detyroje AK-së të korrigjojë këto specifikime për të lejuar që të ofrohen produkte me përbërje ekuivalent e të cilët përmbushin dhe plotësojnë qëllimin e kërkesës për këto dy produkte.

Kështu siç është kurdisur ky tender, kuptohet se edhe çmimi ofertues i OE të favorizuar ka me qenë shumë më i lartë dhe në këtë mënyrë dëmtohet buxheti publik.

Kërkojmë që pretendimi ynë ankimor të merret parasysh, pasi që në këtë mënyrë do të hapej konkurrenca dhe do të ju mundësohet ofertimi të gjitha kompanive të interesuara, njëkohësisht do të parandalohej favorizimi i një OE të caktuar, i cili i posedon këto produkte me përbërjen fikse (strikte) siç është specifikuar nga ana e AK-së.

Pretendimet për produktet në pozicionet 68 dhe 69 janë gjykuar njëherë nga OSHP-ja prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të detyroje AK-së të respektojë vendimin e panelit shqyrtues të **dt.21.04.2026 Nr.2026/0186** dhe të vendoset tek specifikimet teknike fjala EKVIVALENTE.

II. Kërkesa diskriminuese/favorizuese, janë përcaktuar edhe tek mostrat:

Në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar “*Kërkesa 4 Dorzimi i mostrave për materialet e kerkuara sipas paramases dhe specifikimit teknik*”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “*Dëshmia 4: Për produktet me (poz 34, 68, 69)kërkohet nga një mostër te Aneksi 1 Te Specifikimi Teknik ,mostrat duhen të sillen ne kopje fizike para hapjes se ofertave. Vërejtje: Mostrat duhen te sillen ne zyren e prokurimit ne ditën e hapjes para ores 12 :00*”.

Fillimisht duhet cekur se kërkesa për mostra është e panevojshme, ndërsa kjo kërkesë ku është e përcaktuar që të ofrohet mostra vetëm për tri produktet e lartcekura është edhe më kufizuese e edhe më e panevojshme. Kjo kërkesë është favorizuese për një OE të caktuar i cili i posedon në stok këto produkte, ndërsa nëse eventualisht do të ishte e rëndësishme të kërkohej mostra, atëherë është dashur të kërkohej mostra për të gjitha produktet dhe jo vetëm për tre produkte të caktuara.

Nuk duhet orientuar të gjithë fokusin vetëm tek tri produkte dhe atë tek produktet më pak të rëndësishme, që të kërkohej mostra, pasi që nuk kanë asnjë rëndësi mostrat për këto produkte. Për më tepër neni 37.1 i RRPP Nr.001/2022 e përcakton qartë që: “***Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës***”.

Në bazë të kësaj dispozitë nuk është dashur të kërkohej mostra fare për asnjë produkt, ndërsa është edhe më e pa arsyeshme dhe e palogjikshme të kërkohej mostra vetëm për tri produkte Në paramasë janë përcaktuar -kërkuar 69 produkte gjithsejtë, e ku ka barna të ndryshme,

kanilla, shiringa, dorëza etj, ndërsa kërkohen mostra vetëm për tri produkte dhe atë për dezinfektues për duar poz 68, dezinfektues për dysHEME poz.69 dhe për traka të aparatit të glikemisë, ndërkohë që nuk kërkohen mostra për produkte shumë më të rëndësishme të cilat u përmendën me lartë, e po ashtu edhe për Adrenaline, Diazepam apo Gentamicin, etj, të cilat përdoren në situata serioze dhe ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe jetën e pacientëve.

Sipas nenit të 37 të RRPP Nr.001/2022, kërkesa për mostrat duhet të shmanget, mirëpo në rastet kur kërkohen mostrat atëherë të njëjtat duhet të kërkohen vetëm kur janë të domosdoshme për vlerësim real të produktit, jo për çdo produkt dhe jo pa arsye të qartë, sepse përndryshe kufizohet konkurrenca dhe rriten çmimet. Prandaj sipas dispozitës së lartcekur është e qartë se nuk është dashur të kërkohen mostra, ndërsa nëse është e domosdoshme të kërkohen atëherë duhet të kërkohen në mënyrë të arsyeshme dhe për produkte më të rëndësishme.

Andaj kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa për mostra, pasi që drejtpërdrejtë e favorizon kompani të caktuara dhe kufizon konkurrencën.

Gjithashtu duhet cekur fakti se tek specifikimet teknike janë kërkuar mostra për produktet me nr. 34, 68 dhe 69, ndërsa tek kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa është shumë e paqartë sepse janë kërkuar mostra për produktet me nr. 34, 68 dhe 69.

Në këtë rast shtrohet një pyetje se çka do të thotë pozicioni nr. 68 dhe 69 për autoritetin kontraktues dhe shtrohet pyetja përse po kërkohen mostra vetëm për këto produkte?

III. Gjithashtu kërkojmë që të largohen si kërkesa edhe autorizimet për produktet Nr.34, 69 dhe 69, pasi që favorizimi po ndodh për shkak të këtyre tri produkteve. Kërkesa për autorizim për këto tri produkte është kërkesë diskriminuese/favorizuese.

- Me kërkesë për rishqyrtim të dt.27.04.2026, kemi pas pretendime edhe për produktin GLIKOMETER në pozicionin 35, mirëpo AK-së ka bërë korrigjimin e dosjes së tenderit dhe e ka larguar emrin tregtar ELEMENT, prandaj këtë pretendim tani me ankesë e kemi larguar pasi që është hequr emri tregtar dhe është larguar favorizimi për prodhues të caktuar për këtë produkt.

Ne me dt.28.04.2026 kemi pranuar vendimin e autoritetit kontraktues në lidhje me kërkesën për rishqyrtim, ku e njëjta nuk i ka aprovuar të gjitha pretendimet tona ankimore, mirëpo që refuzimi i pretendimeve tona nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe në ndonjë arsyetim konkret të bazuar.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me pozicionet nr.68 dhe 69, ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Sa i përket pozicioneve nr. 68 dhe 69, ju njoftojmë se janë trajtuar në përputhje me Vendimin e OSHP-së, duke bërë sqarime të qarta, të sakta dhe lehtësisht të kuptueshme në dokumentacionin përkatës të tenderit.

Përgjigjja e AK-së nuk qëndron, dhe e njëjta përbën shmangie të zbatimit të vendimit të panelit shqyrtues të OSHP-së. Paneli në vendimin e tij ka kërkuar qartë që të lejohet ekuivalenca, ndërsa AK-ja nuk ka vepruar konform vendimit të OSHP-së, por vetëm ka shtuar një formulim se “specifikat janë minimale”. Ky formulim që ka bërë AK-ja tek specifikat e produkteve të lartcekura nuk ka vlerë fare, kur kemi parasysh faktin se tek specifikimi teknik i këtyre produkteve janë vendosur parametra tepër specifike si 89.1 g etanol 96% produkti në poz.68), 100 g përmbajnë/12g etendial 0.5g pentendial, 7.5g klorur didecildimetilamoniumi (produkti në poz.69) të cilat praktikisht e përjashtojnë çdo produkt tjetër nga konkurrenca dhe e bëjnë ekuivalencën të pamundur. Autoriteti kontraktues në arsyetimin e saj e ka shënuar se pozicionet nr. 68 dhe 69 janë trajtuar në përputhje me vendimin e OSHP-së, mirëpo një gjë e tillë nuk qëndron, sepse nëse do të ishin trajtuar këto produkte/pozicione sipas vendimit të OSHP-së, atëherë është dashur të lejohet ekuivalenca e produkteve dhe jo të bëhet kufizim edhe më i madh i konkurrencës duke specifikuar gramazha strikte tepër të hollësishme të përbërjes së produkteve.

Prandaj kur kemi parasysh faktin se AK-ja nuk ka lejuar ekuivalencën dhe ka specifikuar edhe më hollësisht përbërjen e produkteve pas vendimit të panelit shqyrtues, e njëjta jo vetëm që nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së, por në fakt e ka kufizuar edhe më shumë konkurrencën. Kjo tregon se specifikimet janë të orientuara drejt një produkti apo prodhuesi të caktuar, prandaj sqarojmë se arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim të plotë me vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me kërkesën që të prezantohen mostra vetëm për tri produkte, autoriteti kontraktues është arsyetuar si në vijim:

Po ashtu, kërkesa për dorëzimin e mostrave nga operatorët ekonomikë është vendosur me qëllim të garantimit maksimal të cilësisë, sigurisë dhe stabilitetit të produkteve të ofruara. Mostrat shërbejnë si mekanizëm verifikues substancial, përmes të cilit vërtetohet përputhshmëria teknike, funksionale dhe cilësore e produkteve me specifikimet e kërkuara, si dhe autenticiteti i tyre në raport me autorizimet dhe certifikimet e paraqitura. Në këtë kontekst, Vendimi i OSHP-së konfirmon qartë se kërkesa për mostra është në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-së dhe me RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar, duke e legjitimuar këtë kërkesë si një mjet të domosdoshëm për sigurimin e cilësisë dhe integritetit të procesit të prokurimit.

Arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se i njëjti nuk e trajton drejtpërdrejt pretendimin tonë ankimor. AK-ja ka dhënë vetëm një arsyetim të përgjithshëm duke e shënuar se mostrat shërbejnë për verifikim, pa shpjeguar se përse janë kërkuar mostra vetëm për tri produkte konkrete.

Përderisa autoriteti kontraktues arsyetohet se mostrat janë mekanizëm verifikues substancial, atëherë shtrohet pyetja se a nuk duhet të verifikohen të gjitha produktet?

Nëse autoriteti kontraktues mendon që mostrat konsiderohen të nevojshme për prezantim para ofertimit, atëherë e njëjta do të duhej të kërkonte mostrat për produktet më të rëndësishme, mirëpo në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk është dashur të veprohet në një mënyrë kaq selektive duke kërkuar mostra vetëm për disa produkte jo të rëndësishme, e të cilat produkte siç edhe e kemi cekur më lartë nuk paraqesin ndonjë specifike të veçantë në krahasim me shumë produkte të tjera të kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne edhe një herë po e përsërisim se në paramasë janë kërkuar 69 produkte gjithsejt, e ku në këto pozicione ka barna të ndryshme, kanilla, shiringa, dorëza etj, ndërsa kërkohen mostra vetëm për tri produkte dhe atë për dezinfektues për duar poz 68, dezinfektues për dysheme poz.69 dhe për traka të aparatit të glikemisë, ndërkohë që nuk kërkohen mostra për produkte shumë më të rëndësishme të cilat u përmendën më lartë, e po ashtu edhe për Adrenaline,

Diazepam apo Gentamicin, etj, të cilat përdoren në raste serioze dhe ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe jetën e pacientëve.

Ky veprim i autoritetit kontraktues nuk mund të kuptohet ndryshe nga ana jonë, përveçse favorizim i hapur ndaj një OE të caktuar i cili i posedon tri mostrat e kërkuara në stok, prandaj arsyetimi i AK-së nuk qëndron.

Tek arsyetimi tjetër në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket autorizimeve të kërkuara për produktet nr. 34, 69 dhe 69, e njëjta ka dhënë përgjigjen si në vijim:

Gjithashtu, lidhur me kriteret e përcaktuara në **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**:

- **Kërkesa nr. 2:** Autorizimi nga prodhuesi apo nga dileri i autorizuar nga prodhuesi për pozicionet e kërkuara nga njësia kërkuese është në përputhje të plotë me LPP-në dhe rregulloren përkatëse dhe përbën dëshmi thelbësore të origjinës së produktit dhe të së drejtës legjitime për furnizim.
- **Kërkesa nr. 3:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata nga prodhuesi, përfshirë:
 - Certifikatën ISO
 - Certifikatën CE

Përgjigjja e AK-së edhe në këtë rast është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar, sepse e njëjta ka bërë shmangie nga pretendimi ynë ankimor, përkatësisht e njëjta nuk ka dhënë përgjigje për çështjen që ne kemi ngritur. E njëjta në arsyetimin se saj vetëm përshkruan në mënyrë të përgjithshme se autorizimet dhe certifikatat dëshmojnë origjinën dhe cilësinë e produkteve. Ne edhe një herë po e sqarojmë se pretendimi ynë ka të bëjë me faktin se këto kërkesa janë vendosur vetëm për tri produkte të caktuara, pa dhënë asnjë sqarim konkret pse është bërë një përzgjedhje e tillë.

Përderisa në paramasë janë paraparë disa produkte të natyrës së njëjtë, atëherë përcaktimi i një kërkesë të tillë për vetëm 3 prej tyre, pa një arsyetim të qartë, tregon qartë se kërkesa e AK-së është favorizuese për një OE të caktuar.

Kur kemi parasysh të lartcekurat kuptohet qartë se autoriteti kontraktues me veprimet e saj, duke i refuzuar pretendimet tona ankimore edhe një herë po e tregon qartë favorizimin që po i bën një OE të caktuar, duke mos e marr parasysh fare as vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Dosja e përgatitur në këtë mënyrë, bie ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa dhe me këtë dosje, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur të operatorëve ekonomik që merren me këto furnizime dhe që janë profesional në këtë lëmi.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë: Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se nuk është përpiluar dosja e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan

qartë që “*Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve*”.

Neni 25.6 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik e parasheh qartë “Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë. Në këtë tender kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit nuk janë proporcionale me objektin e kontratës dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe janë kufizuese.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit edhe shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se “*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*”.

Kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

- I. APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE **MEDPLUS SH.P.K**
- II. NDRYSHOHET** dosja e tenderit dhe specifikimet teknike dhe pastaj të vepohet konform nenit 53.7 të LPP-së.
- III. DETYROHET AK-së të respektojë Vendimin e panelit Shqyrtues të dt.21.04.2026 Nr.2026/0186**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nëse nuk bëhen ndryshimet e kërkuara dëmet materiale do të janë shumë të mëdha

v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*